

MINISTRIA E EKONOMISË

2338

Në zbatim të neneve 7, 8, 9, 10, 15, 29, 33, 34, 53 paragrafi 4, 54, paragrafi 2, 56 paragrafi 4, 57 paragrafi 5 dhe 64 paragrafi 3 të ligjit "Për kontrollin e tregtisë së mallrave ushtarake dhe mjeteve vdekjeprurëse joushtarake ("Fletorja zyrtare" numër 80/2013), ministri i ekonomisë, miraton

RREGULLORE

PËR TREGTINË E MALLRAVE USHTARAKE, PRODUKTEVE TË MBROTJES DHE MALLRAVE JOUSHTARAKE VDEKJEPRURËSE

FORMA DHE PËRMBAJTJA E AUTORIZIMIT INDIVIDUAL PËR EKSPORT OSE IMPORT TË MALLRAVE USHTARAKE DHE MALLRAVE JOUSHTARAKE VDEKJEPRURËSE PËR QËLLIME TREGTARE

Neni 1.

- 1) Forma dhe përmbajtja e autorizimit individual për eksport të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse për qëllime ushtarake përcaktohet në formularin MG-PDI, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
- 2) Forma dhe përmbajtja e autorizimit individual për import të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse, për qëllime tregtare, përcaktohet në formularin MG-PDU, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje
- 3) Forma dhe përmbajtja e autorizimit individual për transportin e mallrave joushtarake vdekjeprurëse përcaktohet në rregulloren MG-PDP, e cila është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje

<p align="center">REPUBLIKA E KROACISË MINISTRIA E EKONOMISË Zagreb, Ul.grada Vukovara 78 Tel: +3851-610-61-11 fax: +3851-610-91-50</p>		Numri i autorizimit: <p align="center">AUTORIZIM INDIVIDUAL PËR IMPORT</p> Kategoria: Numri i dosjes:	
Lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, në zbatim të nenit 7 të ligjit "Për kontrollin e mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse (Fletorja zyrtare nr. 80/2013)			
1. IMPORTUESI (EMRI DHE ADRESA)		2. EKSPORTUESI (EMRI DHE ADRESA)	
Nr. i identifikimit		Nr. i identifikimit	
3. NDËRMJETESI (EMRI DHE ADRESA)		4. PËRDORUESI FUNDOR (EMRI DHE ADRESA)	
Nr. i identifikimit:		Nr. i identifikimit:	
5. PËRSHKRIMI I MALLIT		KODI NK/ML	SASIA
			VLERA E MALLIT
6 E VLEFSHME DERI MË:			

Nënshkrimi i personit të autorizuar

Data dhe vula:

FORMA DHE PËRMBAJTJA E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR AUTORIZIM GLOBAL
PËR EKSPORT DHE AUTORIZIM GLOBAL PËR IMPORT TË MALLRAVE USHTARAKE TË
KATEGORISË ML13

Neni 2.

- 1) Forma dhe përmbajtja e autorizimit global të eksportit për eksportin e mallrave ushtarake të kategorisë ML13 është përcaktuar në formularin MG-GID, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
- 2) Kërkesa për autorizim global eksporti për mallrat ushtarake të kategorisë ML13 paraqitet pranë Ministrisë së Ekonomisë, përmes formularit të përcaktuar MG-ZGID, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

<p>REPUBLIKA E KROACISË MINISTRIA E EKONOMISË Zagreb, Ul. grada Vukovara 78 Tel: +3851-610-61-11 fax: +3851-610-91-50</p>		Numri i autorizimit: <p style="text-align: center;">AUTORIZIM GLOBAL PËR EKSPORT</p> Kategoria: Nr. i dosjes:	
Lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, në zbatim të nenit 8 të ligjit "Për kontrollin e mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse" (Fletorja zyrtare nr. 80/2013)			
1. EKSPORTUESI (EMRI DHE ADRESA)		2. SHTETI I DESTINACIONIT	
Nr. i identifikimit			
3. PËRSHKRIMI I MALLIT		4. KODI NK/KODI ML	
5. Kushtet Përpara rieksporimit të mallrave të paraqitura në pikën 3 drejt një shteti destinacion të ndryshëm nga ai i cilësuar në autorizimin e eksportit, duhet të merret miratim me shkrim nga Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kroacisë		6. E VLEFSHME DERI MË:	

Nënshkrimi i personit të autorizuar

Data dhe vula:

FORMA DHE PËRMBAJTJA E DEKLARATËS SË PËRDORUESIT FUNDOR, CERTIFIKATËS
SË PËRDORUESIT FUNDOR DHE FORMULARIT TË KËRKESËS SË PËRDORUESIT
FUNDOR PËR IMPORT TË MALLRAVE USHTARAKE DHE MALLRAVE JOUSHTARAKE
VDEKJEPRURËSE

Neni 3.

1) Forma dhe përmbajtja e deklaratës së përdoruesit fundor përcaktohet në formularin MG-EUS, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

DEKLARATA E PËRDORUESIT FUNDOR

1. Palët

MG - EUS

<p>a) Eksportuesi</p> <p>Emri dhe adresa:</p> <p>Tel:</p> <p>Fax:</p> <p>Email:</p>	<p>b) Importuesi</p> <p>Titulli dhe adresa:</p> <p>Tel:</p> <p>Fax:</p> <p>Email:</p>
<p>c) Përdoruesi fundor:</p> <p>Emri dhe adresa:</p> <p>Tel:</p> <p>Fax:</p> <p>Email:</p>	<p>d) A janë forcat e armatosura ose forcat e sigurisë së brendshme përdoruesi fundor?</p> <p>Vendi specifik ku do të përdoren ose magazinohen mallrat (nëse dihet dhe nëse është i ndryshëm nga (c))</p>

2. Mallrat

<p>a) Sasia e mallrave</p>	<p>b) Vlera e mallrave</p>	<p>c) Përshkrimi i mallrave sipas kontratës, porosisë ose dërgesës (të identifikohet sipas llojit; për mallrat e konsumit, të përfshihet kohëzgjatja e pritshme e jetëgjatësisë së tyre)</p>
----------------------------	----------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

3. Përshkrimi i përdorimit fundor

<p>Lutemi të cilësoni qëllimin e mallrave</p>
<p>Me anë të kësaj, përdoruesi fundor merr përsipër që:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të importojë mallrat e lartpërmendura në vlerën dhe sasinë e treguara; - t'i përdorë mallrat vetëm për qëllimet e paraqitura më lart; - t'i përdorë mallrat vetëm për qëllimet e paraqitura më lart; - të njoftojë Ministrinë e Ekonomisë për çdo ndryshim të rëndësishëm në faktet ose qëllimet e deklaruar; - t'i dorëzojë eksportuesit dëshmi për importin dhe marrjen në dorëzim të mallrave, nëse kërkohet nga eksportuesi ose qeveria e tij; - në asnjë rrethanë, nuk do t'i riekportoje, devijojë ose transferojë mallrat ose pjesë të tyre në destinacione të tjera përveç atyre të lejuara nga Ministria e Ekonomisë. - t'u mundësojë organeve përgjegjëse të kontrollit inspektimin pas transportit të mallrave dhe dokumenteve sipas të cilëve është bërë importi, pa njoftim paraprak.

Me anë të këtij dokumenti konfirmohet se aplikimi, në dijeninë tonë, nuk lidhet me armët e shkatërrimit në masë ose me automjetet për transportin e mallrave të tilla.

Me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, deklaroj se të gjitha të dhënat në këtë deklaratë janë të vërteta.

Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës (me germa të mëdha): _____

Nënshkrimi i personit të autorizuar: _____

Data dhe vula: _____

2) Deklarata e përdoruesit fundor i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë, sipas formularit të caktuar MG-EUS

Neni 4.

1) Forma dhe përmbajtja e certifikatës së përdoruesit fundor në lidhje me importin e mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse për qëllime tregtare është përshkruar në formularin MG-EUC, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

2) Kërkesa për certifikatë përdoruesi fundor, për transport të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse për qëllime tregtare paraqitet pranë Ministrisë së Ekonomisë, në trajtën e formularit të parashikuar MG-ZEUC, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

3) Ministria e Ekonomisë lëshon certifikatë përdoruesi fundor me vlefshmëri deri në një vit.

REPUBLIKA E KROACISË MINISTRIA E EKONOMISË Zagreb, Ul.grada Vukovara 78 Tel: +3851-610-61-11 fax: +3851-610-91-50		Numri i certifikatës: CERTIFIKATË E PËRDORUESIT FUNDOR Kategoria: Nr. i dosjes:	
1. Importuesi:	Nr. i identifikimit:	2. Eksportuesi:	Nr. i identifikimit:
3. Përdoruesi fundor:	Nr. i identifikimit:	4. Ndërmjetësi:	Nr. i identifikimit:
5. PËRSHKIMI I MALLRAVE	KODI NK/ML	SASIA	VLERA E MALLRAVE
<p>Me anë të këtij dokumenti vërtetohet se importuesi i lartpërmendur do të importojë mallrat e mësipërme në territorin doganor të Republikës së Kroacisë. Eksporti i këtyre mallrave në destinacione të tjera nuk do të kryhet përveçse me autorizim nga Ministria e Ekonomisë, në përputhje me ligjin "Për kontrollin e tregtisë së mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse (Fletorja zyrtare, numër 80/2013).</p> <p>Dokumenti është i vlefshëm vetëm nëse është i autorizuar nga Ministria e Ekonomisë. Afati i vlefshmërisë është 12 muaj nga data e lëshimit.</p>			
Nënshkrimi i personit të autorizuar	Vula:	Vendi dhe data:	

APLIKIM PËR CERTIFIKATË PËRDORUESI FUNDOR			
1. Importuesi:		2. Eksportuesi:	
3. Përdoruesi fundor:		4. Ndërmjetësi	
5. PËRSHKRIMI I MALLRAVE	KODI NK/ML	SASIA	VLERA E MALLRAVE
<p>Me anë të këtij dokumenti vërtetohet se importuesi i lartpërmendur do të importojë mallrat e mësipërme në territorin doganor të Republikës së Kroacisë. Eksporti i këtyre mallrave në destinacione të tjera nuk do të kryhet përveçse me autorizim të Ministrisë së Ekonomisë në përputhje me ligjin "Për kontrollin e tregtisë së mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse (Fletorja zyrtare nr. 80/2013). Dokumenti është i vlefshëm vetëm nëse është i autorizuar nga Ministria e Ekonomisë. Afati i vlefshmërisë është 12 muaj nga data e lëshimit.</p>			
Nënshkrimi i personit të autorizuar	Vendi dhe data:	Vula:	

**PËRMBAJTJA DHE MËNYRA E MBAJTJES SË REGJISTRIT TË EKSPORTUESVE DHE
IMPORTUESVE TË MALLRAVE USHTARAKE DHE MALLRAVE JOUSHTARKE
VDEKJEPRURËSE**

Neni 5.

- 1) Regjistrimi në regjistrin e eksportuesve dhe importuesve të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse kryhet në bazë të kërkesës me shkrim, të vërtetuar me vulën dhe nënshkrimin e personit përgjegjës në subjektin juridik ose fizik.
- 2) Përmbajtja e regjistrit sipas paragrafit 1 të këtij neni e përbëhet nga dokumentacioni i parashikuar me nenin 11 paragrafi 2 të ligjit "Për kontrollin e mallrave ushtarake dhe pajisjeve joushtarake vdekjeprurëse" (Fletorja zyrtare nr. 80/2013).
- 3) Në rast se aplikanti nuk paraqet kërkesë të vlefshme ose dokumentacionin e parashikuar, ai duhet të eliminojë mangësitë ose të plotësojë aplikimin brenda afatit të caktuar.
- 4) Njoftimin për mangësitë sipas paragrafit 3 të këtij neni, Ministria e Ekonomisë e përcjell me shkrim, në mënyrë elektronike ose verbale, për të cilin do të mbahet një procesverbal zyrtar.
- 5) Në qoftë se aplikanti nuk e plotëson kërkesën ose nuk i eliminon mangësitë për të cilat është njoftuar brenda afatit të përcaktuar, ai do të konsiderohet se ka hequr dorë nga kërkesa.
- 6) Në regjistër regjistrohen këto të dhëna:
 - Numri rendor i regjistrimit;
 - Data dhe viti i regjistrimit;
 - Emri he selia e personit juridik ose fizik;
 - Numri personal i identifikimit;
 - Të dhëna për personin përgjegjës;
 - Numri i punonjësve;
 - Emri i bankës ku është deponues.
- 7) Në bazë të kërkesës së vlefshme dhe dokumentacionit të nevojshëm të dërguar, Ministria e Ekonomisë miraton vendimin për regjistrimin në regjistër sipas paragrafit 1 të këtij neni.

**FORMA DHE PËRMBAJTJA E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR AUTORIZIM TË
EKSPORTIT OSE IMPORTIT TË MALLRAVE USHTARAKE DHE MALLRAVE
JOUSHTARAKE VDEKJEPRURËSE**

Neni 6.

- 1) Kërkesa për autorizim individual për eksport të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse për qëllime tregtare paraqitet pranë Ministrisë së Ekonomisë, në formatin e parashikuar MG-ZPDI, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
- 2) Kërkesa për autorizim individual për eksport të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse për qëllime tregtare paraqitet pranë Ministrisë së Ekonomisë, në formatin e parashikuar MG-ZPDU, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

3) Kërkesa për autorizim individual për transport të mallrave joushtarake vdekjeprurëse paraqitet pranë Ministrisë së Ekonomisë, sipas formularit të parashikuar MG-ZPDP, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

4) Të gjitha rubrikat e kërkesës duhet plotësohen saktë dhe me shkrim të lexueshëm.

5) Aplikanti mban përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave në kërkesë.

Neni 7.

Bashkë me kërkesën për autorizim individual për eksport ose import të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse, aplikanti duhet të dërgojë edhe dokumentet e mëposhtme:

- specifikimin e municionit të përfunduar dhe komponentëve të tij të veçantë (gëzhoja, kapsolla, barut dhe fishekë), ose specifikimin e armës së zjarrit, nëse kërkesa lidhet me këtë lloj malli,
- kopjet e dokumenteve ku tregohet cilësia dhe karakteristikat teknike të mallit, për mallrat e përfshirë në listën e mallrave ushtarake (në rastin e kimikateve, formulën e strukturës së lëndës dhe numrin e regjistrimit të shërbimit për përmbledhjet kimike CAS,
- llogaritjen ose porosinë
- vërtetimin me të cilin personi juridik ose fizik dëshmon që llogaria bankare përmes së cilës punon nuk është bllokuar gjatë gjashtë muajve të fundit,
- vërtetimin e pagesës së taksës administrative,
- në varësi të llojit të mallit, përdoruesit fundor dhe qëllimit, edhe dokumentacionin e nevojshëm (specifikimi përkatës i mallit, të dhënat e nevojshme në lidhje me destinacionin përfundimtar ose të dhëna të ngjashme).

Neni 8.

1) Aplikanti për autorizim individual për eksport të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse, duhet të dorëzojë autorizimin e importit të lëshuar nga organi kompetent i shtetit në të cilin eksportohet malli dhe kopjen origjinale të certifikatës së përdoruesit fundor të lëshuar ose certifikuar nga organi kompetent i shtetit në të cilin eksportohet malli.

2) Autorizimi i importit i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk është e nevojshme të bashkëlidhet me kërkesën për autorizim individual për eksport nëse organi kompetent i shtetit të importit miraton që për mallrat në fjalë në shtetin importues nuk është e nevojshme të nxirret autorizim importi.

3) Certifikata e përdoruesit fundor sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk i bashkëlidhet kërkesës për autorizim individual për eksport nëse bëhet fjalë për eksport të përkohshëm për qëllime ekspozimi, seminari, stërvitje, testimi, demonstrimi ose riparimi të mallrave nga prodhuesi, si dhe në rastin e kthimit të prodhuesit të mallrave me defekte dhe eksportimit të kampionëve të pajisjeve antiplumb ose mbrojtëse, konstruksioneve dhe komponentëve të kategorisë ML13 të listës së mallrave ushtarake.

Neni 9.

1) Në rast kërkesë jo të plotë, aplikanti i plotëson mangësitë ose kërkesën brenda afatit të caktuar.

2) Njoftimin për mangësitë e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, Ministria e Ekonomisë mund ta dërgojë me shkrim, në rrugë elektronike ose verbalisht, e cila protokollohet zyrtarisht.

3) Në qoftë se aplikanti nuk i korrighon mangësitë ose nuk dorëzon dokumentet mbështetëse të njoftuara brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se ka hequr dorë nga kërkesa.

Neni 10

Eksportuesi ose importuesi ia kthen autorizimin individual të pashfrytëzuar të eksportit ose importit Ministrisë së Ekonomisë, brenda 5 ditëve nga data e skadimit të autorizimit, duke shpjeguar me shkrim arsyet e mosshfrytëzimit të autorizimit.

Neni 11

Në rast humbjeje të autorizimit individual të eksportit ose importit, eksportuesi ose importuesi duhet të njoftojë menjëherë Ministrinë e Ekonomisë, e cila miraton vendimin për anulimin e vlefshmërisë së autorizimit të dhënë brenda datës së njoftimit të bërë.

Neni 12

Gjatë aplikimit për lëshimin e lejes individuale për eksport ose import, i gjithë dokumentacioni shoqërues duhet të jetë i përkthyer në gjuhën kroate nga një përkthyes i autorizuar gjyqësor.

APLIKIM PËR AUTORIZIM INDIVIDUAL PËR EKSPORT		Vula e pranimit		
APLIKIMI NR.:				
SHTETI I EKSPORTIT:				
1. EKSPORTUESI/EMRI DHE ADRESA	Nr. i identifikimit:	2. IMPORTUESI/EMRI DHE ADRESA	Nr. i identifikimit:	
3. NDERMJETËSI/EMRI DHE ADRESA	Nr. i identifikimit:	4. PËRDORUESI FUNDOR/EMRI DHE ADRESA	Nr. identifikimit:	
5. PËRSHKIMI I MALLRAVE:		KODI NK/KODI CL	SASIA	VLERA E MALLRAVE
6. VENDIMI I MPB-së:	Nr. i autorizimit:	7. DOKUMENTE TË TJERA Autorizim importi nr. (IIC) Certifikata e përdoruesit fundor (Nr. EUC)		
8. NUMRI I REGJISTRIMIT NGA GJYKATA TREGTARE:				
9. Emri dhe mbiemri i aplikantit (me germa kapitale)		10. DATA DHE VULA:		
_____		_____		
11. Emri, mbiemri dhe titulli i personit të autorizuar:		12. Nënshkrimi i personit të autorizuar:		
_____		_____		
13 KY APLIKIM:		11. NËNSHKRIMI		
_____ U MIRATUA		MMRK (Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kroacisë) _____		
_____ U REFUZUA		MPB (Ministria e Punëve të Brendshme) _____		
		MJÇE (Ministria e Jashtme dhe Çështjeve Evropiane) _____		
		ME (Ministria e Ekonomisë) _____		
		MF (Ministria e Financave) -Drejtoria e Doganave _____		

APLIKIM PËR AUTORIZIM INDIVIDUAL IMPORTI		Vula e pranimit		
APLIKIM NR:				
SHTETI NGA IMPORTIT:				
1. IMPORTUESI/EMRI DHE ADRESA:	Nr. i identifikimit	2. EKSPORTUESI/EMRI DHE ADRESA	Nr. i identifikimit:	
3. NDERMJETËSI/EMRI DHE ADRESA:	Nr. i identifikimit	4. PËRDORUESI FUNDOR/EMRI DHE ADRESA	Nr. i identifikimit	
5. PËRSHKIMI I MALLRAVE		KODI NK/KODI ML:	SASIA:	VLERA E MALLRAVE:
6. VENDIMI I MPB-së	Numri i autorizimit:	7. QËLLIMI I IMPORTIT:		
8. NUMRI I REGJISTRIMIT NGA GJYKATA TREGTARE				
9. Emri dhe mbiemri i aplikantit (me germa kapitale):		10. DATA DHE VULA:		
_____		_____		
11. Emri, mbiemri dhe titulli i personit të autorizuar:		12. Nënshkrimi i personit të autorizuar:		
_____		_____		
13 KY APLIKIM:		11. NËNSHKRIMI		
_____ U MIRATUAR		MMRK (Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kroacisë) _____		
_____ U REFUZUA		MPB (Ministria e Punëve të Brendshme) _____		
		MVEP (Ministria e Jashtme dhe Çështjeve Evropiane) _____		
		ME (Ministria e Ekonomisë) _____		
		MF (Ministria e Financave) - Drejtoria e Doganave _____		

PËRMBAJTJA DHE MËNYRA E ADMINISTRIMIT TË REGJISTRIT TË OFRUESVE TË SHËRBIMEVE NË LIDHJE ME MALLRAT USHTARAKE

Neni 13

- 1) Regjistrimi në regjistër i ofruesve të shërbimeve në lidhje me mallrat ushtarake bëhet në bazë të kërkesës me shkrim, të vërtetuar me vulën dhe nënshkrimin e personit përgjegjës të presonit juridik ose fizik.
- 2) Përmbajtja e regjistrit të përmendur në paragrafin 1 të këtij neni përbëhet nga dokumentacioni i përshkruar me nenin 30 paragrafi 2 të ligjit "Për kontrollin e tregtisë së mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse ("Fletorja zyrtare", numër 80/2013).
- 3) Në rast se aplikanti nuk dërgon kërkesë të vlefshme ose dokumentacionin e plotë, ai duhet t'i korrigjojë mangësitë ose të plotësojë kërkesën brenda afatit të caktuar.
- 4) Njoftimin për mangësitë e përmendura në paragrafin 3 të këtij neni, Ministria e Ekonomisë mund ta dërgojë me shkrim, në rrugë elektronike ose verbalisht, dhe ai protokollohet zyrtarisht.
- 5) Nëse aplikanti nuk e mbështet kërkesën ose nuk i korrigjon mangësitë për të cilat është njoftuar brenda afatit të caktuar, ai do të konsiderohet se ka hequr dorë nga kërkesa.
- 6) Në regjistër regjistrohen të dhënat e mëposhtme:
 - numri i regjistrimit;
 - data dhe viti i regjistrimit;
 - Emri dhe selia e personit juridik ose fizik;
 - Numri personal I identifikimit;
 - të dhëna e personit përgjegjës;
 - numri i punonjësve;
 - Emri i bankës ku është deponues
- 7) Mbi bazën e kërkesës së vlefshme dhe dokumentacionit të nevojshëm të dorëzuar, Ministria e Ekonomisë merr një vendimin për regjistrimin në regjistër sipas paragrafit 1 të këtij neni.

FORMA DHE PËRMBAJTJA E AUTORIZIMIT PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË LIDHJE ME MALLRAT PËR USHTARAKE

Neni 14

- 1) Forma dhe përmbajtja e autorizimit për ofrimi shërbimesh është parashikuar në formularin MG-DPU, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
- 2) Autorizimi sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk mund t'i transferohet personave të tjerë.

REPUBLIKA E KROACISË MINISTRIA E EKONOMISË Zagreb, Ul.grada Vukovara 78 Tel: +3851-610-61-11 fax: +3851-610-91-50		Numri i autorizimit AUTORIZIM PËR OFRIM SHËRBIMESH Kategoria: Numri i dosjes:	
Lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, në zbatim të nenit 33 të ligjit "Për kontrollin e mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse", (Fletorja zyrtare numër 80/2013)			
1. OFRUESI I SHËRBIMEVE (EMRI DHE ADRESA)		2. EKSPORTUESI (EMRI DHE ADRESA)	
Nr. i identifikimit:		Nr. i identifikimit:	
3. IMPORTUESI (EMRI DHE ADRESA)		4. PËRDORUESI FUNDOR (EMRI DHE ADRESA)	
Numri i identifikimit:		Numri i identifikimit:	
5. PËRSHKRIMI I MALLRAVE		KODI NK/ML	SASIA
			VLERA E MALLRAVE
6. Dokumente të tjera Autorizimi i importit nr. (IIC Nr.) dhe certifikata e përdoruesit fundor nr.		7. E VLEFSHME DERI MË:	

Nënshkrimi i personit të autorizuar

Data dhe vula:

FORMA DHE PERMBAJTJA E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR AUTORIZIM PER
OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË LIDHJE ME MALLRAT USHTARAKE

Neni 15

- 1) Kërkesa për autorizim për kryerje të shërbimeve lidhur me mallrat ushtarake paraqitet pranë Ministrisë së Ekonomisë, me anë të formularit MG-ZDPU të përshkruar, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
- 2) Kërkesa duhet të përcaktojë saktësisht për çfarë lloj shërbimesh bëhet fjalë dhe veprimtaritë e tjera të biznesit që lidhen me mallrat ushtarake, duke përfshirë shërbimet e ndërmjetësimit dhe ndihmën teknike.
- 3) Të gjitha rubrikat e kërkesës duhet të plotësohen në mënyrë të rregullt dhe të lexueshme.
- 4) Aplikanti mban përgjegjësi për saktësinë dhe vërtetësinë e të dhënave në kërkesë.

Neni 16

- 1) Bashkë me kërkesën për lëshimin e autorizimit për ofrimin e shërbimeve në lidhje me mallrat ushtarake, aplikanti duhet të dorëzojë edhe dokumentet e mëposhtme:
 - specifikimin e municionit të përfunduar dhe komponentëve të tij të veçantë (gëzhoja, kapsolla, barut dhe fishekë), ose specifikimin e armës,
 - kopjet e dokumenteve ku paraqitet cilësia dhe karakteristikat teknike të mallit, për mallra nga lista e përbashkët e mallrave ushtarake (kur bëhet fjalë për kimikate, formulën e strukturës së lëndës dhe numrin e regjistrimit të shërbimit për përmbledhjet kimike CAS,
 - kopjen e noterizuar të certifikatës së përdoruesit fundor
 - kopjen e noterizuar të autorizimit të importit
 - vërtetimin me të cilin personi juridik ose fizik dëshmon se llogaria bankare përmes së cilës punon nuk është bllokuar gjatë gjashtë muajve të fundit,
 - vërtetim e pagesës së taksës administrative,
 - dokumentet të tjera të nevojshme, në varësi të llojit të mallit ose shërbimit.
- 2) Autorizimi i eksportit sipas paragrafit 1 nënparagrafi 4 të këtij neni nuk është e nevojshme të bashkëlidhet në qoftë se organi kompetent i shtetit ku eksportohet malli lëshon vërtetimin që për mallin në fjalë, në shtetin e importit, nuk është e nevojshme të nxirret autorizim importi.

Neni 17

Me kërkesë të Ministrisë së Ekonomisë, ofruesi i shërbimeve është i detyruar të dërgojë vërtetimin e marrjes në dorëzim të mallit për qëllime ushtarake, të lëshuar nga përdoruesit fundor dhe të certifikuar nga organi shtetëror i përdoruesit fundor.

Neni 18

- 1) Në rastin e një kërkesë jo të plotë, aplikanti duhet të korrigjojë mangësitë ose të plotësojë kërkesën brenda afatit të caktuar.

2) Njoftimin për mangësitë e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, Ministria e Ekonomisë mund ta dërgojë me shkrim, në rrugë elektronike ose verbalisht dhe njoftimi protokollohet zyrtarisht.

3) Në qoftë se aplikanti nuk e plotëson kërkesën ose nuk i korrigjon mangësitë për të cilat është njoftuar në afatin e caktuar, do të konsiderohet se ai ka hequr dorë nga kërkesa.

Neni 19

Autorizimin e pashfrytëzuar të eksportit ose të importit, eksportuesi ose importuesi duhet t'ia kthejë Ministrisë së Ekonomisë brenda 5 ditëve nga data e skadimit të autorizimit, duke shpjeguar me shkrim shkaqet e mosshfrytëzimit të autorizimit në fjalë.

Neni 20.

Në rastin e humbjes së autorizimit të eksportit ose importit, eksportuesi ose importuesi duhet të njoftojë Ministrinë e Ekonomisë, e cila do të miratojë vendimin për anulimin e vlefshmërisë së autorizimit të lëshuar në datën e njoftimit.

Neni 21.

Kur aplikohet për autorizim eksporti ose importi, i gjithë dokumentacioni shoqërues duhet të jetë i përkthyer në gjuhën kroate nga përkthyes i autorizuar gjyqësor.

APLIKIM PËR AUTORIZIM PËR OFRIM SHERBIMESH		Vula e pranimit		
APLIKIM NUMËR:				
SHTETI I IMPORTIT:				
1. OFRUESI I SHËRBIMEVE/ EMRI DHE ADRESA:	Nr. i identifikimit:	2. EKSPORTUESI/ EMRI DHE ADRESA:	Nr. i identifikimit:	
3. IMPORTUESI/ EMRI DHE ADRESA:	Nr. i identifikimit:	4. PËRDORUESI FUNDOR/ EMRI DHE ADRESA:	Nr. i identifikimit:	
5. PËRSHKIMI I MALLRAVE:		KODI NK/KODI ML	SASIA:	VLERA E MALLRAVE:
6. NUMRI I REGJISTRIMIT NË REGJISTRIN: Numri i aprovimit:		7. NR. I CERTIFIKATËS SË PËRDORUESIT FUNDOR:		
8. NUMRI I REGJISTRIMIT NGA GJYKATA TREGTARE:				
9. Emri dhe mbiemri i aplikantit (me germa kapitale) _____		10. DATA DHE VULA: _____		
11. Emri, mbiemri dhe titulli i personit të autorizuar: _____		12. Nënshkrimi i personit të autorizuar: _____		
13 KY APLIKIM: _____ U MIRATUA _____ U REFUZUA		11. NËNSHKRIMI MMRK (Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kroacisë) MPB (Ministria e Punëve të Brendshme) MJÇE (Ministria e Jashtme dhe Çështjeve Evropiane) ME (Ministria e Ekonomisë) MF Drejtoria e Doganave (Ministria e Financave)		_____ _____ _____ _____ _____

FORMA DHE PËRMBAJTJA E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR AUTORIZIM GLOBAL
PËR TRANSFERIM TË PRODUKTEVE TË MBROJTJES DHE LIÇNCË VJETORE PËR
TRANSFERIM TË PRODUKTEVE TË MBROJTJES

Neni 22

- 1) Forma dhe përmbajtja e autorizimit global për transferim të produkteve të mbrojtjes është përcaktuar në formularin MG-GDP, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
- 2) Kërkesa për autorizim vjetor për transferimin e produkteve të mbrojtjes paraqitet pranë Ministrisë së Ekonomisë, me formularin e përshkruar MG-ZGDP, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
- 3) Me kërkesën për dhënien e autorizimit vjetor për transferim të produkteve të mbrojtjes, aplikanti është i detyruar që të bashkëlidhë edhe dokumentet e mëposhtme:
 - Dëshmi për instalimin e programit të harmonizimit të brendshëm (PHB),
 - Dëshmi për ekzistencën e marrëdhënieve të biznesit me marrësin e produkteve të mbrojtjes,
 - Specifikimin e produkteve të mbrojtjes,
 - Dëftesën tarifore/ kodin ML të produkteve të mbrojtjes,
 - Vërtetimin me të cilin personi juridik ose fizik tregon se llogaria bankare nëpërmjet të cilës operon nuk është bllokuar gjatë gjashtë muajve të fundit,
 - Dëshmi të pagesës së taksës administrative dhe
 - Në varësi të llojit të mallit dhe llojit të shërbimit, edhe dokumentacione të tjera të nevojshme.

REPUBLIKA E KROACISË MINISTRIA E EKONOMISË Zagreb, Ul. grada Vukovara 78 Tel: +3851-610-61-11 fax: +3851-610-91-50		Numri i autorizimit AUTORIZIM PËR OFRIM SHËRBIMESH Kategoria: Numri dosjes:
Lëshuar nga Ministria e Ekonomisë, në zbatim të nenit 53 të ligjit "Për kontrollin e mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse, (Fletorja zyrtare numër 80/2013)		
1. FURNIZUESI/MARRËSI (EMRI DHE ADRESA):	Nr. i identifikimit:	2. SHTETI I DESTINACIONIT - ORIGJINA:
3. PËRSHKRIMI I MALLRAVE	4. KODI NK/KODI ML	
5. Kushtet Rieksporti i mallrave të paraqitura në pikën 3 nga shteti i destinacionit drejt një shteti tjetër, nuk duhet të bëhet pa miratimin me shkrim nga Ministria e Ekonomisë e Republikës së Kroacisë.		6. E VLEFSHME DERI MË:

Nënshkrimi i personit të autorizuar

Data dhe vula:

KËRKESË PËR AUTORIZIM GLOBAL PËR TRANSFERIM		Vula e pranimit
Numri i aplikimit:		
1. FURNIZUESI/MARRËSI (EMRI DHE ADRESA)	Nr. i identifikimit:	2. SHETETI I DESTINACIONIT – ORIGINËS:
3. PËRSHKRIMI I MALLRAVE	4. KODI NK/KODI ML	
5. NUMRI I REGJISTRIMIT I GJYKATËS TREGTARE		
6. Emri dhe mbiemri i aplikantit (me germa kapitale)	7. DATA DHE VULA	
_____	_____	
8. Emri, mbiemri dhe titulli i personit të autorizuar: (me germa kapitale)	9. Nënshkrimi i personit të autorizuar:	
_____	_____	
10. KJO KËRKESË: _____ U MIRATUA _____ U REFUZUA	11. NËNSHKRIMI MMRK (Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Kroacisë) _____ MPB (Ministria e Punëve të Brendshme) _____ MJÇE (Ministria e Jashtme dhe Çështjeve Evropiane) _____ ME (Ministria e Ekonomisë) _____ MF Drejtoria e Doganave (Ministria e Financave) _____	

ELEMENTET BAZË TË PROGRAMIT TË HARMONIZIMIT TË BRENDSHËM

Neni 23

- 1) Programi i harmonizimit të brendshëm duhet të përmbajë këto elemente bazë:
 1. Deklaratën për politikën e kompanisë lidhur me kontrollin e produkteve të mbrojtjes dhe të mallit të eksportuar/importuar për qëllime ushtarake,
 2. Emërimin e punonjësve përgjegjës për kontrollin e transferimit ose të importit/eksportit,
 3. Mbajtjen e evidencave administrative dhe të transaksioneve,
 4. Trajnimin e punonjësve përgjegjës për çështjet e transportit ose të eksportit/importit,
 5. Procedurat e auditimit të brendshëm në përputhje me procedurat e përshkruara në programin e harmonizimit të brendshëm,
 6. Përshtatjen e urdhrin në përputhje me programin e harmonizimit të brendshëm,
 7. Informimin e organeve shtetërore kompetente në rastin e aktiviteteve të paautorizuara dhe të dyshimta,
 8. Verifikimin e palës me të drejta të kufizuara (persona fizikë ose juridikë)
 9. Klasifikimin e produkteve dhe të teknologjisë për përcaktimin nëse malli i është nënshtruar kontrollit ose nëse është përfshirë në listën e mallrave që janë objekt kontrolli,
 10. Sistemin për verifikimin e rrezikut të kthimit të mallit nga destinacioni i miratuar.
- 2) Së bashku me kërkesën për verifikimin e programit të harmonizimit të brendshëm, aplikanti dërgon dokumentin që pasqyron harmonizimin e brendshëm të kompanisë për kryerjen e veprimeve të transferimit të produkteve të mbrojtjes brenda Bashkimit Evropian dhe në përputhje me dhjetë elementet e paraqitura më lart.
- 3) Gjatë përpunimit të programit të harmonizimit të brendshëm, marrësi/pranuesi mund të përdorë formularët dhe udhëzimet në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë (www.mingo.hr)
- 4) Verifikimin e programit të harmonizimit të brendshëm e kryen komisioni për dhënie autorizimit për eksport dhe import të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse, transport të produkteve të mbrojtjes dhe ofrim shërbimesh në lidhje me mallrat ushtarake, në bazë të kërkesës me shkrim të marrësit/pranuesit të produktit të mbrojtjes.
- 5) Gjatë punës së tij, Komisioni zbaton Rekomandimin e Komisionit të 11 janarit 2011 për certifikimin e kompanive të mbrojtjes sipas nenit 9 të Direktivës së Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian 2009/43/KE për unifikimin e kushteve për transferimin e produkteve të mbrojtjes brenda Bashkimit Evropian (SL, 15.1.2011).
- 6) Në rastin e opinionit pozitiv nga Komisionit, ministri i ekonomisë miraton vendimin që shoqëria e caktuar (Furnizuese/pranuese) të ketë ngritur sistemin e harmonizimit të brendshëm.
- 7) Vërtetimi lëshohet për një periudhë trevjeçare, pas së cilës ai mund të rinovohet me të njëjtin afat.

**FORMA DHE PËRMBAJTJA E KËRKESËS PËR AUTORIZIM INDIVIDUAL PËR
TRANSFERIM TË PRODUKTEVE TË MBROJTJES DHE AUTORIZIM INDIVIDUAL PËR
TRANSFERIM TË PRODUKTEVE TË MBROJTJES**

Neni 24

- 1) Forma dhe përmbajtja e autorizimit individual për transferim të produkteve të mbrojtjes është përshkruar me formularin MG-PDP, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
- 2) Kërkesa për autorizim individual për transferim të mallrave të mbrojtjes paraqitet pranë Ministrisë së Ekonomisë, me anë të formularit më shkrim MG-ZPDP, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
- 3) Bashkë me kërkesën për autorizim të unifikuar për transferim të produkteve të mbrojtjes, aplikanti duhet të bashkëlidhë edhe dokumentet e mëposhtme:
 - Specifikimin e municionit të përfunduar dhe komponentëve të tij të veçantë (gëzhoja, kapsolla, barut dhe fishekë), ose specifikimin e armës,
 - Kopjet e dokumenteve ku paraqitet cilësia dhe karakteristikat teknike të mallit, për mallra nga lista e mallrave ushtarake (kur bëhet fjalë për kimikate, formulën e strukturës së lëndës dhe numrin CAS të regjistrimit të shërbimeve kimike,
 - Ilogaritjen ose porosinë
 - Vërtetim me të cilin personi juridik ose fizik dëshmon se llogaria përmes së cilës operon nuk është bllokuar gjatë gjashtë muajve të fundit,
 - Vërtetim mbi pagesën e taksës administrative,
 - Në varësi të lloji të mallit, përdoruesin fundor ose aplikimim dhe dokumentacione të tjera të nevojshme (specifikimin përkatës të mallit, të dhënat e nevojshme për destinacionin përfundimtar dhe/ose të dhëna të ngjashme).

Neni 25

- 1) Aplikanti për transferim të produkteve të mbrojtjes është i detyruar që të bashkëlidhë autorizimin e lëshuar nga organi kompetent i shtetit në të cilin transferohet malli dhe kopjen origjinale të certifikatës së përdoruesit fundor të lëshuar ose të certifikuar nga organi kompetent i shtetit në të cilin do të transferohet malli.
- 2) Autorizimi dhe certifikata e përdoruesit fundor sipas paragrafit 1 të këtij neni nuk është e nevojshme të bashkëlidhet me kërkesën për transferim, në rast se nuk parashikohet nga legjislacioni i shtetit në të cilin bëhet transferimi ose nëse bëhet fjalë për transferim për qëllime ekspozimi, seminari, trajnimi, testimi, demonstrimi ose riparimi të mallit nga prodhuesi, si dhe nëse bëhet fjalë për kthimin e mallit me defekt te prodhuesi dhe transferimin e kampioneve të pajisjeve të blinduara ose mbrojtëse, konstrukteve dhe komponentëve të kategorisë ML13 të listës së produkteve të mbrojtjes

Neni 26.

- 1) Në rastin e një kërkesë jo të plotë, aplikanti duhet të korrigjojë mangësitë ose të plotësojë kërkesën brenda afatit të caktuar.
- 2) Njoftimin për mangësitë sipas paragrafit 1 të këtij neni, Ministria e Ekonomisë mund ta dërgojë me shkrim, në rrugë elektronike ose verbalisht, dhe njoftimi protokollohet zyrtarisht.
- 3) Në qoftë se aplikanti nuk e plotëson kërkesën ose nuk i korrigjon mangësitë për të cilat është njoftuar brenda afatit të caktuar, do të konsiderohet se ai ka hequr dorë kërkesa.

Neni 27.

Autorizimin për transferim të pashfrytëzuar, marrësi /furnizuesi ia kthen Ministrisë së Ekonomisë brenda 5 ditëve nga data e skadimit të autorizimit, duke shpjeguar me shkrim shkaqet e mosshfrytëzimit të tij.

Neni 28.

Në rast humbjeje të autorizimit për transferim, marrësi/furnizuesi duhet të njoftojë menjëherë Ministrinë e Ekonomisë, e cila do të miratojë vendim për anulimin e vlefshmërisë së autorizimit në datën e kryerjes së njoftimit.

Neni 29.

Kur aplikohet për lëshimin e autorizimit të transferimit, i gjithë dokumentacioni duhet të jetë i përkthyer në gjuhën kroate nga përkthyesi ligjor.

**FORMA DHE PËRMBAJTJA E DEKLARATËS SË PËRDORUESIT FUNDOR, CERTIFIKATËS
SË PËRDORUESIT FUNDOR DHE FORMULARIT TË KËRKESËS PËR CERTIFIKATË TË
PËRDORUESIT FUNDOR PËR TRANSFERIMIN E PRODUKTEVE TË MBROJTJES**

Neni 30.

1) Forma dhe përmbajtja e deklaratës së përdoruesit fundor është përshkruar në formularin MG-EUSP, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

DEKLARATA E PËRDORUESIT FUNDOR

1. Palët

MG – EUSP

<p>a) Marrësi</p> <p>Emri dhe adresa:</p> <p>Tel:</p> <p>Fax:</p> <p>Email:</p>	<p>b) Furnizuesi</p> <p>Emri dhe adresa:</p> <p>Tel:</p> <p>Fax:</p> <p>Email:</p>
<p>c) Përdoruesi fundor:</p> <p>Emri dhe adresa</p> <p>Tel:/cel.</p> <p>Fax:</p> <p>Email:</p>	<p>d) A janë forcat e armatosura ose forcat e sigurisë së brendshme përdorues fundorë?</p> <p>PO/JO</p> <p>Vendi specifik ku do të përdoren ose magazinohen mallrat (në qoftë se dihet dhe është i ndryshëm nga (c))</p>

2. Mallrat

<p>a) Sasia e mallrave</p>	<p>b) Vlera e mallrave</p>	<p>c) Përshkrimi i mallrave sipas kontratës, porosisë ose dërgesës (të identifikohen sipas llojit; për mallrat e konsumit, të cilësohet edhe kohëzgjatja e pritshme e furnizimit)</p>
-----------------------------------	-----------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

3. Përshkrim i përdorimit fundor

<p>Lutemi specifikoni qëllimin e mallrave</p> <p>Me anë të këtij dokumenti, përdoruesi fundor ka detyrimet e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none"> - të transferojë mallrat mësipërme sipas vlerës dhe sasisë së treguar; - t'i përdorë mallrat vetëm për qëllimet e mësipërme; - të njoftojë Ministrinë e Ekonomisë për çdo ndryshim të rëndësishëm në faktet ose qëllimet e deklaruar; - t'i dorëzojë furnizuesit dëshmi të transferimit dhe marrjes në dorëzim të mallrave, nëse kërkohet nga furnizuesi ose qeveria e tij; - të mos riekportoje, devijojë ose ringarkojë në asnjë rrethanë mallrat ose pjesët e tyre në destinacione të tjera përveç atyre të lejuara nga Ministria e Ekonomisë. - t'u mundësojë organeve përgjegjëse të kontrollit inspektimin pas dërgimit të mallrave dhe dokumenteve sipas të cilave është bërë transferimi, pa njoftim paraprak. <p>Me anë të këtij dokumenti vërtetojmë se aplikimi, në dijeninë tonë, nuk lidhet me armë të shkatërrimit në masë ose me automjetet për dërgimin e këtyre mallrave.</p>

Me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale, deklaroj se të gjitha të dhënat në deklaratë janë të vërteta.

Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës (me germa kapitale) _____

Nënshkrimi i personit të autorizuar: _____

Emri dhe mbiemri i personit të autorizuar (me germa kapitale): _____

Data dhe vula: _____

2) Deklarata për përdoruesin fundor i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë me formularin e përshkruar MG-EUSP.

Neni 31.

1) Forma dhe përmbajtja e certifikatës së përdoruesit fundor për transferim të produkteve të mbrojtjes është përshkruar me formularin MG-EUCP, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.

2) Kërkesa për certifikatë përdoruesi fundor për transferimin e produkteve të mbrojtjes bëhet pranë Ministrisë së Ekonomisë, me formularin e përshkruar MG-ZEUCP, i cili është pjesë e kësaj rregulloreje.

3) Ministria e Ekonomisë jep certifikatën e përdoruesit fundor me afat vlefshmërie deri në një vit.

<p align="center">REPUBLIKA E KROACISË MINISTRIA E EKONOMISË Zagreb, Ul.grada Vukovara 78 Tel: +3851-610-61-11 fax: +3851-610-91-50</p>	Numri i autorizimit: <p align="center">CERTIFIKATA E PËRDORUESIT FUNDOR</p> Kategoria: Numri i dosjes:		
1. MARRËSI Nr. i identifikimit	2. Furnizuesi Nr. i identifikimit		
3. Përdoruesi fundor Nr. i identifikimit:	4. Ndërmjetësi Nr. i identifikimit:		
5. PËRSHKIMI I MALLRAVE	KODI NK/KODI ML	SASIA	VLERA E MALLRAVE
<p>Me anë të kësaj konfirmohet se marrësi i lartpërmendur do të kryejë transferimin e mallrave në territorin doganor të Republikës së Kroacisë. Transferimi i këtyre mallrave në ndonjë destinacion tjetër kryhet vetëm me autorizim nga Ministria e Ekonomisë në përputhje me ligjin "Për kontrollin e tregtisë së mallrave ushtarake dhe pajisjeve joushtarake vdekjeprurëse (Fletorja zyrtare numër 80/2013) Dokumenti është i vlefshëm vetëm në qoftë se është certifikuar nga Ministria e Ekonomisë. Afati i vlefshmërisë është 12 muaj nga data e lëshimit të tij.</p>			
Nënshkrimi i personit të autorizuar	Vula:	Vendi dhe data:	

KËRKESË PËR CERTIFIKATË PËRDORUESI FUNDOR			
1. Marrësi:		2. Furnizuesi:	
3. Përdoruesi fundor:		4. Ndërmjetësi:	
5. PËRSHKIMI I MALLRAVE	KODI NK/KODI ML	SASIA	VLERA E MALLRAVE
<p>Me anë të këtij dokumenti vërtetohet se marrësi i lartpërmendur do të transferojë këto mallra në territorin doganor të Republikës së Kroacisë. Transferimi i këtyre mallrave në destinacione të tjera kryhet vetëm me autorizim nga Ministria e Ekonomisë në përputhje me ligjin "Për kontrollin e tregtisë së mallrave ushtarake dhe të mallrave joushtarake vdekjeprurëse (Fletorja zyrtare numër 80/2013). Dokumenti është i vlefshëm vetëm në qoftë se është i autorizuar nga Ministria e Ekonomisë. Afati i vlefshmërisë është 12 muaj nga data e lëshimit.</p>			
Nënshkrimi i personit të autorizuar	Vula:	Vendi dhe data:	

FORMA DHE PËRMBAJTJA E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR LËSHIM CERTIFIKATE
DHE E CERTIFIKATËS PËR PERSONAT JURIDIKË OSE FIZIKË QË MERREN ME
PRODHIMIN E PRODUKTEVE TË MBROJTJES

Neni 32.

- 1) Forma dhe përmbajtja e certifikatave për personat juridikë dhe fizikë që merren me prodhim të produkteve të mbrojtjes përshkruhet në formularin MG-CERT, i cili është pjesë përbërëse e kësaj rregulloreje.
- 2) Ministria e Ekonomisë e lëshon certifikatën për personat juridikë ose fizikë që merren me prodhim të produkteve të mbrojtjes në gjuhën kroate dhe një kopje në gjuhën angleze, për nevoja të raportimit të detyrueshëm ndaj Komisionit Evropian në përputhje me nenin 70 të ligjit "Për kontrollin e tregtisë së mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse (Fletorja zyrtare numër 80/2013).

REPUBLIKA E KROACISË MINISTRIA E EKONOMISË Zagreb, Ul.grada Vukovara 78 Tel: +3851-610-61-11 fax: +3851-610-91-50
ÇERTIFIKATË Lëshuar sipas Direktivës 2009/43/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 6 majit 2009 për unifikimin e kushteve për transferimin e produkteve të mbrojtjes brenda Bashkimit Evropian
Certifikatë nr. XXX-
NdërmarrjaMarrësi (emri i ndërmarrjes – marrësi) Regjistruar me numër..... (numri i regjistrimit tregtar) Adresa (vendi, rruga, kodi postar, qyteti) Në bazë të kërkesave të nenit 9 paragrafi 2 të Direktivës 2009/43/KE të përmendur në nenin 65 të ligjit "Për kontrollin e tregtisë së mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse" (Fletorja zyrtare numër 80/2013) Ndërmarrja e certifikuar – marrësi dhe njësitë e tij prodhuese të paraqitura në listën e mëposhtme janë të autorizuar të pranojnë produktet e mbrojtjes për prodhim të tyre dhe për qëllime mirëmbajtjeje dhe riparimi sipas autorizimeve të përgjithshme për transferim nga shtete të tjera anëtare. Adresat e njësive prodhuese:
Rubrika opsionale për përjashtim: Kjo certifikatë mundëson pranimin e produkteve të mbrojtjes të përfshira në listën e përbashkët të produkteve të Bashkimit Evropian, përveç kategorive të mëposhtme:
Kushtet e kësaj certifikate janë paraqitur në nenin 65 të ligjit "Për kontrollin e mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse (Fletorja zyrtare numër: 80/2013) Vlefshmëria e kësaj certifikate fillon më: (data e hyrjes në fuqi) deri në..... (data e skadimit)
Lëshuar më (vendi) Më (data e lëshimit)
(Nënshkrimi i autoritetit kompetent të certifikimit)

3) Kërkesa për lëshimin e certifikatës për pranim të produkteve të mbrojtjes paraqitet në Ministrinë e Ekonomisë, në formularin e përshkruar MG-ZCERT, i cili është pjesë përbërëse i kësaj rregulloreje.

EMRI DHE ADRESA E MARRËSIT
KËRKESË PËR LËSHIM CERTIFIKATE PËR PRANIMIN E PRODUKTEVE TË MBROJTJES sipas Direktivës 2009/43/KE të Parlamentit Evropian dhe Këshillit të 6 majit 2009 për unifikimin e kushteve për transferimin e produkteve të mbrojtjes brenda Bashkimit Evropian
Ndërmarrja – Marrësi:..... (emri i ndërmarrjes – marrësi) Numri i regjistrimit:..... (numri i regjistrimit në regjistrin tregtar) Adresa: (vendi, rruga, kodi postar, qyteti) Me anë të këtij dokumenti vërtetohet se marrësi dhe njësitë e tij prodhuese të specifikuar në listën e mëposhtme do t'i pranojnë produktet për qëllime të prodhimit të tyre dhe për nevoja mirëmbajtje dhe riparimi sipas autorizimeve për transferim të publikuar shtetet e tjera anëtare. Adresat e njësisve prodhuese:
Rubrika opsionale për përjashtim: Me këtë certifikatë mundësohet pranimi i kategorive vijuese të produkteve të mbrojtjes nga lista e përbashkët e produkteve të Bashkimit Evropian:
Kërkesa për dhënie të certifikatës për pranimin e produkteve ushtarake është bërë në zbatim të nenit 64 të ligjit "Për kontrollin e mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse" (Fletorja zyrtare numër: 80/2013)
Emri dhe mbiemri i personit përgjegjës (me germa kapitale) _____ (Nënshkrimi i personit të autorizuar) _____
Vendi, data dhe vula:

Neni 33.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohen rregulloret e mëposhtme:

- Rregullorja për formularin e kërkesës për autorizim në lidhje me eksportin ose importin e mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse ("Fletoret zyrtare" numër 1/2009 dhe 26/2013),
- Rregullorja për formularin e kërkesës për autorizim për ofrimin të shërbimeve (Fletoret zyrtare numër 1/2009 dhe 26/2013),
- Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e kërkesës dhe autorizimit të përgjithshëm për eksport të mallrave ushtarake të kategorisë ML13 ("Fletoret zyrtare" numër 1/2009 dhe 26/2013),
- Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e autorizimit për ofrimin e shërbimeve në lidhje me mallrat ushtarake ("Fletoret zyrtare" numër 1/2009 dhe 26/2013),
- Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e certifikatës së përdoruesit fundor për import të mallrave ushtarake dhe mallrave joushtarake vdekjeprurëse ("Fletoret zyrtare" numër 1/2009 dhe 26/2013),
- Rregullorja për përmbajtjen dhe formën e autorizimit për eksport ose import të mallrave ushtarake dhe të mallrave joushtarake vdekjeprurëse për qëllime tregtare ("Fletoret zyrtare" numër 1/2009 dhe 26/2013),
- Rregullorja për përmbajtjen dhe mënyrën administrimit të regjistrit të ofruesve të shërbimeve për mallrat ushtarake ("Fletoret zyrtare" numër 1/2009 dhe 26/2013),

Neni 34.

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e botimit të saj në "Fletoren zyrtare".

Kategoria:
Nr. serial:
Zagreb, 31 korrik 2013

011-01/13-01/222
526-04-01-02/1-13-7

Ministri i
Ekonomisë
Ivan Vrdoljak, d.v.